



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF 01/2023

KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.13 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenin 22, paragrafin 1 me nënparagrafin 1.13 dhe 1.14 dhe Nenit 53, paragrafit 1 me nënparagrafin 1.2 dhe Nenit 54 të Statutit të OMK-së si dhe Nenit 23, paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK-së, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 15 shkurt 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

për
CAKTIMIN TAKSAVE ADMINISTRATIVE NË OMK

(Plotësim/ndryshimin e Vendimit me nr. ref. KO.12/2022 i datës 16.02.2022)

Neni 1

Taksat administrative për identifikim dhe regjistrim

- I. Mjeku anëtar i OMK-së për rrethanat e mëposhtme është i obliguar që të paguajë taksat administrative si në vijim:
 - I.I Taksë administrative për regjistrim në Regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, në shumë prej 5.00 (pesë) € (euro);
 - I.II Taksë administrative për reregjistrim në Regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, në shumë prej 100 (njëqind) € (euro);
 - I.III Taksë administrative për reregjistrimin e dytë në Regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, në shumë prej 200.00 (dyqind) € (euro);

I.IV Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës për shkak të ndërrimit të statusit profesional, për shkak të humbjes apo dëmtimit të kartelës së anëtarësisë në OMK në shumë prej 2.00 (dy) € (euro);

Neni 2

Taksat administrative për Edukim Specialistik

I. Mjeku anëtar i OMK-së, që i nënshtrohet procesit të Edukimit Specialistik, obligohet që të bëjë pagesën e taksave administrative si në vijim:

I.I. Taksë administrative për aplikim për paraqitjen e provimit specialistik në shumë prej 10.00 (dhjetë) € (euro);

I.II. Taksë administrative për provimin specialistik në shumë prej 180.00 (njëqind e tetëdhjetë) € (euro);

I.III. Taksë administrative për Çertifikatën e provimit specialistik në shumë prej 15.00 (pesëmbëdhjetë) € (euro);

I.IV. Taksë administrative për Librezën e specializimit në shumë prej 20.00 (njëzet) € (euro);

Neni 3

Taksat administrative për licencim, rilicencim dhe vlerësim në EVP

I. Mjeku anëtar i OMK-së i cili parashtron kërkesat e tij/saj për shqyrtim pranë organeve gjegjëse kompetente të OMK-së, është i obliguar që të paguajë taksat si në vijim:

I.I. Taksë administrative për parashtrim të aplikacionit për valorizim të pikëve kredituese të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në shumë prej 10.00 (dhjetë) € (euro);

I.II. Taksë administrative për dhënie të Licencës së punës pas procesit të Rilicencimit, në shumë prej 40.00 (dyzet) € (euro) për kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh;

I.III. Taksë administrative për dhënie të Licencës së punës pas procesit të Rilicencimit, në shumë prej 10.00 (dhjetë) € (euro) kohëzgjatje prej një (1) viti, dispozitë e cila vlen vetëm për mjekun që është në procesin e Edukimit Specialistik;

I.IV. Taksë administrative për dhënie të Licencës së punës pas procesit të Licencimit për herën e parë, në shumë prej 50.00 (pesëdhjetë) € (euro) për kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh;

I.V. Taksë administrative për ekzemplarën e dublifikuar të licencës së punës në shumë prej 15.00 (pesëmbëdhjetë) € (euro);

I.VI. Taksë administrative për lëshim të faksimilit në shumë prej 15.00 (pesëmbëdhjetë) € (euro);

I.VII. Taksë administrative për lëshim të faksimilit të dytë në shumë prej 10.00 (dhjetë) € (euro);

I.VIII. Taksë administrative për paraqitjen e provimit për rilicencim për mjekët të cilët kanë mungesë të pikëve akredituese nga 5-49 pikë, në shumë prej 150.00 (njëqind e pesëdhjetë) € (euro);

I.XIX. Taksë administrative për paraqitjen e provimit për rilicencim për mjekët të cilët kanë mungesë të pikëve akredituese nga 50-100 pikë, në shumë prej 400.00 (katërqind) € (euro).

Neni 4

Taksat administrative në procedurat e mbikëqyrjes etike

I. Taksat administrative që ndërlidhen me veprimtarinë e mbikëqyrjes etike, përcaktohen si në vijim:

I.I Taksë administrative për lëshim të certifikatës për të kaluarën etike (“Certificate of good standing”), në gjuhën shqipe në shumë prej 25 (njëzet e pesë) € (euro); dhe

I.II Taksë administrative për lëshim të certifikatës për të kaluarën etike (“Certificate of good standing”), në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze në shumë prej 30 (tridhjetë) € (euro).

II. Taksat administrative sipas paragrafit I të këtij Neni, lëshohen për përdorim brenda dhe jashtë territorit Republikës së Kosovës, varësisht nga kërkesa e parashtruar nga mjeku anëtar i OMK-së.

III. Lirohet nga pagesa e taksës administrative për lëshim të certifikatës sipas parag I me nënparagrafin I.I të këtij Neni, mjeku anëtar i OMK-së të cilit i nevojitet dokumenti për çështje që përcaktohen në Rregulloren (QRK) Nr. 02/2023 për Shtesën e Nëpunësit të Sistemit Shëndetësor.

Neni 5

Taksat administrative për dhënien e lejes për hulumtime biomjekësore

- I. Aplikuesit për dhënien e lejitimit për hulumtime biomjekësore, persona fizik apo juridik, do të jenë të obliguar që të paguajnë taksën administrative si në vijim:
 - I.I. Për persona fizikë (individë) qytetarë të Republikës së Kosovës të cilët janë mjek anëtar të OMK-së, në shumë prej 120.00 (njëqind e njëzet) € (euro);
 - I.II. Për persona fizikë (individë) qytetarë të Republikës së Kosovës të cilët nuk janë mjek anëtar të OMK-së në shumë prej 420.00 (katërqind e njëzet) € (euro);
 - I.III. Për persona fizikë (individë) qytetarë jo kosovarë dhe të cilët nuk janë mjek anëtar të OMK-së, në shumë prej 480.00 (katërqind e tetëdhjetë) € (euro);
 - I.IV. Për persona juridik, organizata jofitimprurëse të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumë prej 180.00 (njëqind e tetëdhjetë) € (euro);
 - I.V. Për persona juridik, organizata fitimprurëse të regjistruara në Republikën e Kosovës në shumë prej 480.00 (katërqind e tetëdhjetë) € (euro); dhe
 - I.VI. Për persona juridik, organizata ndërkombëtare që nuk janë të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe nuk janë në marrëdhënie partneriteti me njësitë e Qeverisë së Kosovës në shumë prej 420.00 (katërqind e njëzet) € (euro).
- II. Organi kompetent i OMK-së i cili lejon hulumtimin, taksën administrative varësisht nga kategoria e përcaktuar në paragrafin I të këtij neni, do ta përcaktojë me rastin e lejitimit të hulumtimit.
- III. Lirohet nga taksat administrative për implementimin e hulumtimeve bio-mjekësore sipas paragrafit I të këtij Neni, studenti i cili është në përfundim të studimeve themelore si dhe studimeve të doktoratës, i cili/a nuk ka sponzorues për implementimin e hulumtimit bio-mjekësor sipas kërkesës së parashtruar.
- IV. Lirohet nga taksat administrative për implementimin e hulumtimeve bio-mjekësore sipas paragrafit I të këtij Neni, mjeku anëtar i OMK-së i cili/a me rastin e aplikimit për

hulumtim bio-mjekësor jep deklaratë me shkrim se nuk ka sponsorues për implementimin e hulumtimit biomjekësor sipas kërkesës së parashtruar.

Neni 6

Zbatimi i taksave administrative

I. Taksa administrative sipas Nenit 3 paragrafit I me nënparagrafin I.I., për iniciimin e procedurës së valorizimit të pikëve kredituese për EVP nuk kthehet në rast të refuzimit të rilicencimit.

II. Me rastin e dhënies së licencës, shuma e taksës së paguar për iniciim të procedurës për valorizim të pikëve kredituese për EVP për procesin e rilicencimit sipas parag I të këtj Neni, do të llogaritet në totalin e taksës administrative për lëshim të licencës së punës.

III. Taksat administrative lidhur me edukimin specialistik, do të jenë të zbatueshme pas bartjes së kompetencës mbi Edukimin Specialistik nga Ministria e Shëndetësisë tek OMK-ja.

Neni 7


Hyrja në fuqi

I. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha Vendimet paraprake që kanë përcaktuar lartësinë e taksave administrative në OMK.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i OMK-së.

Prishtinë, 15 shkurt 2023

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. Dci



Faqe 5 nga 5